

SEKSIONI I TRETË  
VENDIM

**Kërkesat nr. 45354/16 dhe 56514/21,  
Arben BIÇAKU kundër Shqipërisë  
dhe Klodian RJEPAJ kundër Shqipërisë**  
(shihni tabelën bashkëngjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 18 dhjetor 2025, si Komitet i përbërë nga:

Diana Kovatcheva, *President*,

Canòlic Mingorance Cairat,

Vasilka Sancin, *gjyqtarë*,

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit*,

Duke pasur parasysh kërkesat më sipër të depozituara më 25 korrik 2016 dhe 16 nëntor 2021,

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

**FAKTE DHE PROCEDURA**

Lista e kërkesave jepet në shtojcë.

Ankimet e kërkesave, sipas nenit 6 dhe 8 të Konventës dhe nenit 1, të Protokollit nr. 1 të Konventës, i janë komunikuar qeverisë shqiptare e cila dorëzoi parashtrimet për pranueshmërinë dhe themelin.

Parashtrimet iu dërguan kërkesave, të cilët u ftuan që të paraqesin parashtrimet e tyre me shkrim. Kërkesit nuk paraqitën asnjë përgjigje.

Me anë të shkresave të dërguara me postë rekomande dhe përmes Shërbimit të Komunikimit Elektronik të Gjykatës (*eComms*), kërkesit dhe përfaqësuesit e tyre u njoftuan që periudha e lejuar për paraqitjen e parashtrimeve të tyre kishte mbaruar dhe që nuk ishte kërkuar shtyrje e afatit. Më tej, kërkesit u vunë në dijeni për nenin 37, paragrafi 1 (a) të Konventës, sipas të cilit Gjykata mund të vendosë të heqë nga lista e çështjeve një kërkesë, kur rrethanat çojnë në përfundimin se kërkesi nuk synon të vazhdojë ta ndjekë çështjen.

Megjithatë, nuk vijoi asnjë përgjigje.

**LEGJISLACIONI**

Gjykata e gjen të përshtatshme që të shqyrtojë kërkesat e tyre bashkërisht në një vendim të vetëm.

Nisur nga sa më sipër, Gjykata del në përfundimin që mund të konsiderohet se kërkesit nuk dëshirojnë më të ndjekin kërkesat e tyre (neni 37, paragrafi 1 (a) i Konventës). Gjithashtu, në përputhje me nenin 37, paragrafi 1 *in fine*, Gjykata nuk gjen rrethana të veçanta, në lidhje me respektimin e të drejtave të njeriut, siç përcaktohen në Konventë dhe në Protokollin e saj sipas të cilave do të kërkohej vazhdimi i shqyrtimit të kërkesave.

Në këto rrethana, çështjet duhet të hiqen nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht:

*vendos* të bashkojë kërkesat;

*vendos* të heqë kërkesat nga lista e çështjeve të saj.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 22 janar 2026.

**Viktoriya Maradudina**  
ZËVENDËSKANCELARE NË DETYRË

**Diana Kovatcheva**  
PRESIDENT

**SHTOJCË**

**Lista e kërkesave**

Nr.	Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkesit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e shkresës rekomande të Gjykatës
1	45354/16 25.7.2016	Arben BIÇAKU 1975	Arben RAKIPI Tiranë	26.6.2025 (dorëzuar më 8.7.2025)
2	56514/21 16.11.2021	Klodian RJEPAJ 1971	Kostandin TRANDAFILI Tiranë	20.6.2025 (dorëzuar më 8.7.2025)